



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:031403

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05436403

P.nr.1025/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm Penal, gjyqtari gjykues Fatmir Krasniqi, me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **L.B.**, nga Arbana-Prizren, për shkak të vepres penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-es, i akuzuar me aktakuze PP.nr.1373-7/2018 të datës 25.06.2018, me datë **11.03.2024** morri këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarit **L.B.**, nga Arbana-Prizren, ku edhe tani jeton, ne rr..... pnr, për shkak të vepres penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-se, **për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.**

Shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate.

Perf.i te demtuares KEDS-distrikti ne Prizren, per realizimin e kerkeses pasurore juridike udhezohet ne kontest te rregullt civilo-juridik

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prizren pranë Gjykatës Themelore – departamenti i përgjithshëm në Prizren, ka parashtruar aktakuze PP.nr.1373-7/2018 të dt.25.06.2018 kundër të akuzuarit L.B., nga Arbana-Prizren, për shkak të vepres penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-se.

Për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-se, është paraparë dënimi me me gjobe ose me burgim deri ne 3 vite, keshtu qe sipas kesaj dispozite, paraqitet parashkrimi relativ kurr kalon koha prej 3 viteve nga dita e kryerjes së veprës penale, ndërsa sipas dispozitës të nenit 107 par.1 lidhur me par.8 te KPK-ës, parashkrimi absolut paraqitet kurr kalon dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, përkatësisht periudha prej 6 viteve.

Vepra penale në këtë çështje penale është kryer me dt. 05.03.2018, meqë nga data e kryerjes së veprës penale ka kaluar koha prej me shume se 6 viteve, e paraparë për parashkrim absolut, **andaj ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale.**

Andaj Gjykata në kuptim të nenit 107 par. 1 lidhur me par.8 të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me nenin 320 të KP-se, vendosi si në dispozitiv të këtijë aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muarr në kuptim të nenit 454 par.2 të KPPK-ës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i pergjithshem penal
P.nr.1025/2018 te dt.11.03.2024

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 dite, pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.